

RR E G U L L O R E

“MBI KRITERET DHE PROÇEDURAT ADMINISTRATIVE PËR MARRJEN E LICENCAVE TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË RESTAURATORIT”

Në mbështetje të nenit 17 të ligjit 9048, dt. 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, hartohet kjo rregullore që përmban kriteret dhe procedurat për marrjen e licencave për ushtrimin e profesionit të restauratorit.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores dhe fusha e veprimit

1. Kjo rregullore përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në:
 - a) Organizimin dhe funksionimin e strukturave që merren me procedurat e liçensimit të subjekteve në fushën e restaurimit.
 - b) Klasifikimin e punimeve të restaurimit, kushtet dhe kriteret që duhen plotësuar për t’u pajisur me liçensë profesionale.
 - c) Të drejtat që kanë personat fizikë dhe juridik për t’u pajisur me liçensë në fushën e restaurimit, detyrimet që ka administrata shtetërore për realizimin e trajtimit konform dispozitave ligjore të kërkesave të personave fizikë dhe juridikë.

Neni 2

Përkufizim i termave

1. “**Këshilli Kombëtar i Restaurimit (KKR)**” është organ kolegjal pranë Ministrisë së Kulturës, bazuar në ligjin 9048, dt.07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar icili shqyrton kërkesat e personave fizik dhe juridik për dhënien e licencave profesionale në fushën e restaurimit.
2. “**Liçensë profesionale**” është dokumenti me të cilën pajiset çdo person fizik ose juridik (që plotëson kërkesat e kësaj rregullore) i cili kërkon të ushtrojë veprimtari projektuese apo/edhe zbatuese në fushën e restaurimit.
3. “**Eksperiencë pune**” janë vitet e punës në profesion pas diplomimit të dokumentuar me librezë pune ose çdo dokument tjetër të barazvlefshëm me të. Me përjashtim të rasteve të Licencave në kategorinë “B”: Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale”.
4. “**Arsim i lartë**”- Arsimit në degën përkatëse që ka lidhje me restaurimin të vërtetuar me diplomë.

5. “**Kategori**” është Specifikimi i llojit të veprimtarisë restauruese, bazuar në klasifikimin sipas gjinisë së monumenteve.
6. “**Formular Shoqëruese e kërkesës**” është fletë evidentuese që shoqëron çdo kërkesë me shënimet përkatëse të punonjësve të Sekretarisë teknike të KKR nga pranimi deri tek vendimi i Komisionit.

KREU II

LIÇENSAT PROFESIONALE, KLASIFIKIMI DHE KATEGORITË

Neni 3

Liçensa dhe klasifikimi e kategoritë e punimeve.

1. Liçensa është dokument juridik e profesional që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar sipas klasifikimit dhe kategorive të punimeve të fituara në fushën e monumenteve të arkitekturës dhe artit.
2. Formati i licencave miratohet sipas anekseve bashkelidhur.

Neni 4

Llojet e licencave

1. Llojet e licencave janë:

➤ *Liçensë profesionale individuale:*

“AP. Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”.

“AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”

“B. Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale”

➤ *Liçensë profesionale për shoqëri projektimi dhe shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës.*

“CP. Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi”.

“CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.

Neni 5

Afatet e vlefshmërisë së Liçensës.

1. Liçensat e miratuara sipas kësaj rregulloreje janë me afat si më poshtë:
 - a) Liçensë profesionale personale me afat të pacaktuar;
 - b) Liçensë profesionale për shoqëri projektimi dhe shoqëri ndërtimi me afat në varësi të kontratës së lidhur me projektuesin restaurator dhe drejtuesin teknik restaurator (kontratë me afat minimalisht 1-vjecare).

KREU III
KUSHTET DHE KRITERET PËR TË FITUAR LIÇENSË
DETYRAT DHE TË DREJTAT E SUBJEKTEVE QË LIÇENSOHEN

Neni 6
Kriteret për liçensim

1. Çdo person fizik e juridik ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë Sekretarisë Teknike të KKR për t'u pajisur me liçensë profesionale personale ose për shoqëri projektimi e ndërtimi në restaurimin e monumentet e trashëgimisë së arkitekturës, sipas kategorive të përcaktuara, pasi të ketë plotësuar kushtet paraprake për kategoritë si më poshtë:

A. “AP. Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”

- “AP/1. Projektim në konservimin e restaurimin e rrënojave arkeologjike”;
- “AP/2. Projektim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4);
- “AP/3. Projektim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të kategorisë së parë dhe të dytë”;
- “AP/4. Projektim në restaurimin dhe rikualifikimin e qendrave historike”.

A.1 Arsimi

Për të përftuar liçensën “AP/1” kërkesi duhet të ketë diplomën e mëposhtme:

- Diplomë të shkollës së lartë në degët: arkitekturë, urbanistikë, inxhinieri ndërtimi, histori, arkeologji;
- Diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njohur nga MAS e barazvlefshme me diplomat e përmendura në pikën e mësipërme.

Janë të pranueshme si dokument shtesë:

- Diplomë masteri profesional, shkencor ose doktoraturë për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, kualifikime nga institucione të njohura kombëtarehdendërkombëtare dhe studime shkencore në fushën e restaurimeve;

Për të përftuar liçensën AP/2, AP/3, AP/4 kërkesi duhet të ketë diplomën ee mëposhtme:

- Diplomë të shkollës së lartë në degët: arkitekturë, urbanistikë, inxhinieri ndërtimi;
- Diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njohur nga MAS e barazvlefshme me diplomat e përmendura në pikën e mësipërme.

Janë të pranueshme si dokument shtesëtë diplomave në pikat më lart:

- Diplomë masteri profesional, shkencor ose doktoraturë për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, kualifikime nga institucione të njohura kombëtarehdendërkombëtare dhe studime shkencore në fushën e restaurimeve;

A.2 Eksperienca në punë

- Të ketë jo më pak se 7 vjet punë në profesionin për të cilin është diplomuar;
- Të jetë bashkëautor në hartimin e së paku 3 projekteve restaurimi të monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës për secilën pikë.

B. “AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturë”

- “AZ/1. Zbatim në konservimin e restaurimin e rrënojave arkeologjike”;
- “AZ/2. Zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4)”;
- “AZ/3. Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të kategorisë së parë dhe të dytë”;
- “AZ/4. Zbatim në restaurimin dhe rikualifikimin e qendrave historike”.

B.1 Arsimi:

Për të përftuar licënsën “AZ/1” kërkuesi duhet të duhet të ketë diplomën emëposhtme:

- Diplomë të shkollës së lartë në degët: arkitekturë, urbanistikë, inxhinieri ndërtimi, histori, arkeologji;
- Diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njohur nga MAS e barazvlefshme me diplomat e përmendura në pikën e mësipërme.

Janë të pranueshme si dokument shtesëtë diplomave në pikat më lart:

- Diplomë masteri profesional, shkencor ose doktoraturë për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, kualifikime nga institucione të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare dhe studime shkencore në fushën e restaurimeve;

Për të përftuar licënsën “AZ/2”, “AZ/3”, “AZ/4” kërkuesi duhet të ketë diplomë mëposhtme:

- Diplomë të shkollës së lartë në degët: arkitekturë, urbanistikë, inxhinieri ndërtimi;
- Diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njohur nga MAS e barazvlefshme me diplomat e përmendura në pikën e mësipërme.

Janë të pranueshme si dokument shtesëtë diplomave në pikat më lart:

- Diplomë masteri profesional, shkencor ose doktoraturë për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, kualifikime nga institucione të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare dhe studime shkencore në fushën e restaurimeve;

B.2 Eksperienca në punë

- Të ketë jo më pak se 7 vjet punë në profesionin për të cilin është diplomuar.
- Të ketë qenë pjesë e grupit të zbatimit e së paku 3 projekteve restaurimi të monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës për secilën pikë.

C. “B. Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale”

- B/1. Projektim dhe zbatim në restaurimin e mozaikëve;

- B/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve;
- B/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin e veprave të artit në dru.

C.1 Arsimi

Për të përfutur licënsën në pikat B/1, pika B/2, pika B/3, kërkuesi duhet të ketë një të një nga diplomat e mëposhtme:

- Të ketë mbaruar shkollën e mesme profesionale;
- Të ketë mbaruar Akademinë e Arteve, Dega Pikturë ose Skulpturë;
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega Kimi ose Biokimi;
- Diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njohur nga MAS e barazvlefshme me diplomat e përmendura në pikat e mësipërme.

Janë të pranueshme si dokument shtesë të diplomave në pikat më lart:

- Diplomë masteri profesional, shkencor ose doktoraturë për restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale;

C.2 Eksperienca në punë:

- Të ketë jo më pak se 7 vjet punë në profesion për të cilin është diplomuar.
- Të jetë bashkautor në hartimin dhe zbatimin, së paku të 3 projekteve restaurimi të veprave të artit dhe objekteve muzeale për secilën pikë.
- Për personat që kanë mbaruar arsimin e mesëm të ketë jo më pak se 15 vjet eksperiencë punë në restaurime veprave të artit dhe objekteve muzeale, të faktuara me dokumentacionin përkatës (libreza e punës ose çdo dokument tjetër të barazvlefshëm me të).

D. “CP. Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi”.

1. Shoqëria e projektimit fiton licënsë profesionale në fushën e projektimit në restaurim mbështetur në Licënsën profesionale të Drejtuesit Teknik, restaurator i monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës.

E. “CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi.

1. Shoqëria e ndërtimit fiton licënsë profesionale në fushën e zbatimit të punimeve në restaurimit mbështetur në Licënsën Profesionale të Drejtuesit Teknik, restaurator i monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e subjekteve të licënuar

1. Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të licënuara në fushën e restaurimeve janë:

- a) Të njohë dhe të kryejë veprimtari në përputhje aktet ligjore e nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore;
- b) Të njohë dhe të zbatojë në veprimtarinë e saj rregullat e sigurimit teknik në punë;
- c) Çdo shoqëri e licencuar nuk duhet të ushtrojë asnjë veprimtari në mungesë të Drejtuesit teknik restaurator;
- d) Projektuesi restaurator mund të ushtrojë veprimtarinë e tij si i tillë vetëm në një shoqëri projektimi ose si konsulent në hartimin e projekteve të ndryshme në fushën e restaurimit;
- e) Drejtuesi teknik restaurator mund të ushtrojë veprimtarinë e tij si i tillë vetëm në një shoqëri ndërtimi.

KREU IV

DOKUMENTET QË SHOQËROJNË KËRKESËN PËR LIÇENSË PROFESIONALE

Neni 8

Për Liçensë profesionale individuale

1. Kërkesa për pajisje me liçensë profesionale personale për herë të parë duhet të përmbajë:
 - a) Formular aplikimi me të dhëna kryesore: Emri, atësia, mbiemri, vendlindja, adresa, vendi i punës, numri i telefonit dhe dy kopje fotografish 3 x 4cm. Sipas formularit bashkëngjitur kësaj rregullore (Aneksi 1);
 - b) Vetdeklarim mbi përgjegjësinë mbi llojin e veprimtarisë që kërkon të kryej, që nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor në proces. (Sipas Aneksit 2);
 - c) Veprimtaria e kryer nga marrja e diplomës deri në momentin e kërkesës, vërtetuar nga institucione ose investitorë të ndryshëm;
 - d) Në formularin e aplikimit, aneksi i punëve të ngjashme duhet e plotësuar dhe në formë elektronike (minimumi 3 punë të ngjashme për çdo kategori) (shkarkohet nga Faqja zyrtare e IMK)
 - e) Diplomë (kopje e noterizuar);
 Fakultative është dorëzimi i kualifikimeve si mëposhtë:
 - f) Kualifikimet apo specializimet dhe kontribute të veçanta nëpërmjet certifikatave të lëshuara nga organet kompetente.

Neni 9

Kërkesa për shtesë kategorie për liçensë profesionale personale

Kërkesa për pajisje me liçensë personale shtesë pikash duhet të përmbajë:

- a) Kërkesë me shkrim në formë autobiografie teknike (Curriculum Vitae) me të dhëna kryesore: Emri, atësia, mbiemri, vendlindja, adresa, vendi i punës, numri i telefonit dhe dy kopje fotografish 3 x 4cm. Sipas formularit bashkëngjitur kësaj rregullore (Aneksi 1);
- b) Vetdeklarim mbi përgjegjësinë mbi llojin e veprimtarisë që kërkon të kryej, që nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor në proces. (Sipas Aneksit 2);

Fakultative është dorëzimi i kualifikimeve si mëposhtë:

- c) Listën e veprimtarisë shkencore, botime, pjesëmarrje ne aktivitete ndërkombëtare, si dhe dëshmi për specializime pasuniversitare.

Instituti i Monumenteve të Kulturës në çdo rast do të verifikoj punët e ngjashme të shënuara në formularin e aplikimit nëpërmjet arkivit të saj dhe komunikimit zyrtar në formë shkresore apo me email me DRKK-të përkatëse. Në rastet e aplikimeve për shtesë pikash nga individët, DRKK-të duhet të japin dhe një vlerësim mbi cilësinë e punimeve, projekteve apo zbatimeve dhe nëse ka ose jo penalizime për shkelje të kritereve të restaurimit.

Neni 10

Për Liçensë për shoqëri ndërtimi dhe shoqëri projektimi dhe shtesa të saj

Kërkesa për pajisje me liçensë profesionale të shoqërisë ndërtimore dhe shoqëri projektimi duhet të shoqërohet:

- a) Formular aplikimi me të dhëna kryesore: Emri,atësia, mbiemri, vendlindja, adresa, vendi i punës, të dhënat e QKB-së, numri i telefonit i drejtuesit ligjor dhe teknik të shoqërisë, autobiografi teknike (Curriculum Vitae); Sipas formularit bashkëngjitur kësaj rregullore (Aneksi 3);
- b) Vetdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë shoqëria, (sipas kategorive dhe llojet e përcaktuara në liçensën profesionale të drejtuesit teknik në fushën e restaurimeve) që nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka asnjë proces gjyqsor në proces.(Sipas Aneksit 2);
- c) Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të tatim – taksave deri në momentin e paraqitjes së kërkesës (nga bashkia dhe Drejtoritë tatimore);
- d) Vetdeklarim i drejtuesit teknik (restaurator) se nuk punon si i tillë në ndonjë shoqëri tjetër si dhe nuk është në marrëdhënie pune me shtetin dhe do të zbatoj në veprimtarinë e saj parimet e restaurimit, rregullat e sigurimit teknik në punë dhe aktet ligjore e nënligjore në fushën e restaurimit. .(Sipas Aneksit 2);
- e) Kontrata e punës ndërmjet shoqërisë të përfaqësuar nga drejtuesi ligjor dhe drejtuesit teknik restaurator i monumenteve të arkitekturës, (e noterizuar).
- f) Në rast se Drejtuesi Teknik Restaurator është njëkohësisht edhe drejtues ligjor i shoqërisë, atëherë vlefshmëria e liçensës do të jetë sa afati i vlefshmërisë së shoqërisë i përcaktuar nga QKB. Këto subjekte për çdo ndryshim në aktivitetin e shoqërisë kanë detyrim të paraqesin njoftim Ekstrakt Historik të QKB pranë Sekretarisë Teknike të KKR.

Instituti i Monumenteve të Kulturës në çdo rast do të verifikoj punët e ngjashme të shënuara në formularin e aplikimit nëpërmjet arkivit të saj dhe komunikimit zyrtar në formë shkresore apo me email me DRKK-të përkatëse. Në rastet e aplikimeve për shtesë pikash nga individët, DRKK-të duhet të japin dhe një vlerësim mbi cilësinë e punimeve, projekteve apo zbatimeve dhe nëse ka ose jo penalizime për shkelje të kritereve të restaurimit.

Neni 11
Për dhënie dublikatë license

1. Për lëshimin e dublikatës së liçensës subjekti duhet të paraqesë:
 - a) Formular aplikimi, ku paraqitet aktiviteti i ushtruar. (Sipas aneksit 3);

Neni 12
Për ndryshim drejtuesi teknik restaurator

1. Ndryshimi i drejtuesit teknik restaurator, miratohet nga Ministri Kulturës, pas propozimit të KKR. Shoqëria ndërtimore ose e projektimit në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Formular aplikimi. (Sipas aneksit 3)
 - b) Kontrata e punësimit midis drejtuesit ligjor dhe atij teknik (restaurator) të ri;
 - c) VetDeklaratë e drejtuesit teknik (restaurator) se nuk punon si i tillë në ndonjë shoqëri tjetër si dhe nuk është në marrëdhënie pune me shtetin dhe mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë shoqëria, që nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor në proces.(Sipas Aneksit 2);;

Neni 13
Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë, çregjistrimi

1. Në rastin kur një shoqëri nuk ushtron më veprimtari restauruese për një sërë arsye, ose shoqëria nuk është më aktive sipas rregjistrave të QKR, subjekti duhet të paraqes pranë Sekretarisë Teknike të KKR:
 - a) Njoftim me shkrim nga drejtuesi ligjor, për çregjistrimin e shoqërisë.

Neni 14
Kërkesa për rinovim license për shoqëri projektimi/ndërtimore

1. Kërkesa për rinovim liçensë për shoqëri projektimi duhet të përmbajë:
 - a) Formular Aplikimi (Sipas Aneksit 3);
 - b) Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të tatim – taksave;
 - c) Kontrata e punës midis shoqërisë dhe drejtuesit teknik të licencuar në fushën e restaurimit.

KREU V

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE NË FUSHËN E RESTAURIMIT.

Neni 15

Përgatitja e materialeve për dhënie e licencave

1. Rendi i ditës për mbledhjen e KKR caktohet nga kryetari i KKR në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm të KKR, i cili është Drejtor i IMK.
2. KKR shqyrton materialin që ka të bëjë me liçensimin e subjekteve, i cili përgatitet nga Sekretaria Teknike e KKR pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”.
3. Sekretaria Teknike e KKR kërkon nga Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare informacion për veprimtarinë restauruese të personave të cilët kërkojnë të liçensohen. Informacioni paraqitet në materialin e KKR.
4. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen pjesëtarëve të KKR jo më vonë se pesë ditë para ditës së caktuar për mbledhje.
5. Materiali i përgatitur nënshkruhet nga përgjegjësi i zyrës së Sekretarisë Teknike të KKR si dhe nga Sekretari i përgjithshëm i KKR.

Neni 16

Marrja e vendimeve

1. KKR shqyrton kërkesat e subjekteve të interesuar për liçensë në fushën e restaurimeve.
2. Ministri i Kulturës me Urdhër zbardh liçensën në fushën e restaurimeve.

Neni 17

Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave

1. Kërkesa për liçensë dhe dokumentet shoqëruese të saj sipas kësaj rregulloreje, depozitohen pranë Sekretarisë Teknike të KKR në Institutin e Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”.
2. Çdo kërkesë shqyrtohet paraprakisht brenda ditës nëse përmban të plotë e të saktë gjithë dokumentacionin përkatës sipas kësaj rregulloreje.
3. Në formularin e aplikimit bëhen shënime dhe ajo nënshkruhet nga përgjegjësi i Sekretarisë Teknike i cili jep edhe mendim me shkrim për dokumentacionin e paraqitur.

Neni 18

Ruajtja, arkivimi dhe shpërndarja e licencave.

1. Në bazë të vendimit të KKR përgatitet Liçensa në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave pas nënshkrimit të Ministrisë, i dorëzohet subjektit përkatës e vulosur, ndërsa tjetra ruhet për arkivim.

2. Liçensat profesionale janë dokumente me vlerë që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm. Format i tyre propozohet nga KKR dhe miratohet nga Ministri Kulturës.
3. Sekretaria teknike përgjigjet për arkivimin sipas rregullave të dokumentit të liçensës.
4. Shpërndarja e licencave të interesuarve bëhet me postë ose dorazi nga personeli i Sekretarisë Teknike, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e vendimit.

Neni 19

Paraqitja, protokoli, regjistrat dhe Arkivi

1. Çdo kërkesë dhe dokumentacioni shoqërues sipas kësaj rregullore duhet të jetë i daktilogruar dhe në gjuhën shqipe (dokumentat në gjuhë të huaj të jenë të përkthyer dhe të noterizuar).
2. Çdo dokument i fotokopjuar duhet të jetë i noterizuar.
3. Sekretaria Teknike mban dhe ruan sipas rregullave në fuqi:
 - Protokoll për evidentimin e kërkesave të subjekteve për liçensim
 - Regjistër themeltar për regjistrimin e licencave profesionale personale dhe të shoqërive ndërtimore.
 - Arkivi i Sekretarisë vendoset pranë IMK.

KREU VI

REGJISTRIMI I LICENCAVE PROFESIONALE DHE SHOQËRIVE

Neni 20

Tarifat licencave

- | | |
|---|-------------|
| 1. Liçensë personale | 6 000 lekë |
| 2. Liçensë profesionale për shoqëri projektimi dhe shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumente të trashëgimisë së arkitekturës. | 20 000 lekë |
- Pagesa e tarifës së licencave kryhet pas njoftimit nga Sekretaria Teknike, e cila ka për detyrë të njoftoj personat/subjektet pas daljes së vendimit të KKR-së.
Këto tarifa kryhen për çdo aplikim, përveç rasteve të dhënies së dublikatit.

Neni 21

Regjistrimi i Licencave profesionale

1. Liçensa hartohet në dy kopje origjinale dhe regjistrohet në Regjistrat Themeltarë të licencave profesionale personale dhe të Shoqërive duke pasqyruar edhe përmbajtjen e saj.
2. Regjistrimet duhet të jenë të sakta, të qarta, pa korrigjime, me vijueshmërinë e numrit rendor dhe pa shkurtime.
3. Në regjistrat themeltarë të regjistrimit nuk lejohet të fshihet asgjë.

4. Rregullimet bëhen me numër rendor të ri me fraksion.
5. Një kopje origjinale e Liçensës së bashku me praktikën e sjellë nga kërkuesi, mbahet në arshivën e Sekretarisë Teknike. Regjistrimi i licencave profesionale dhe ruajtja e tyre bëhet në bazë të ligjit për arkivat.

KREU VII

SANKSIONE DHE RREGULLIME TE TJERA

Neni 22

Heqja e liçensës apo Pezullimi i përkohshëm

1. Heqja e të drejtës për ushtrimin e aktivitetit apo pezullimin e përkohshëm behet me Vendim të KKR në rastet kur:
 - a) Në dokumentet që shoqërojnë kërkesën ka deklarime të rreme.
 - b) Ka falsifikime të dokumenteve të paraqitura.
 - c) Shoqëria e ndërtimit kryen veprimtari restauruese pa praninë e drejtuesit teknik.
 - d) Ka propozim të motivuar nga IMK, DRMK në rrethe, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, Organet e Qeverisjes Vendore, Tatim Taksave, Doganave, për shkeljen e ligjshmërisë apo kritereve në restaurim ose ndërtim, në veprimtari në proces apo të kryera më parë.
 - e) Liçensa personale profesionale konsiderohet e pavlefshme kur dokumentohet se personi nuk ka aftësi fizike, apo mendore dhe nuk mund të ushtrojë normalisht veprimtarinë për të cilën është liçensuar.
 - f) Liçensa personale profesionale konsiderohet e pavlefshme kur mbajtësi i saj humbet jetën
 - g) Për çdo rast hartohet një raport vlerësimi i cili shqyrtohet në mbledhjen e radhës së KKR dhe vendimi përkatës merret nga Ministri i Kulturës.

Neni 23

Regullime te tjera dhe kufizime ne perdorimin e liçensës

1. Kur subjekti i liçensuar është punonjës i administratës shtetërore të Ministrisë së Kulturës, ose të institucioneve në varësi të saj, liçensa e tij pezullohet deri në momentin e përfundimit të këtij funksioni. Në rastin e kundërt kur një subjekt i liçensuar punësohet në administratën shtetërore ai është i detyruar të njoftojë Sekretariatit Teknik të KKR për pezullim license. Në rast mos njoftimi dhe përdorimit të saj, KKR vendos heqjen e saj.
2. Kur ndërrohet drejtuesi ligjor i shoqërisë, shoqëria është e detyruar të njoftojë Sekretariatit Teknik për ndryshimin. Sekretaria e Teknike reflekton ndryshimet ne formatin e licenses pas miratimit nga KKR.
3. Liçensat e miratuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje të cilat kanë afat të përcaktuar, pas përfundimit të afatit do ti nënshtrohen rregullave dhe procedurave të kësaj rregulloreje.
4. Liçensat pa afat vazhdojnë me të njëjta kushte me të cilat janë miratuar.

5. Nuk lejohen të pajisen me liçensë në fushën e restaurimit të gjithë profesionistët që në momentin e paraqitjes së kërkesës për liçensë, janë anëtarë të KKR.
6. Liçensa nuk lejohet të transferohet nga një person fizik a juridik tek tjetri.
7. Kur Subjekti humbet liçensën profesionale njofton menjëherë zyrtarisht Sekretarinë Teknike të KKR dhe pajiset me dublikatë pas plotësimit të dokumentacionit .

Neni 24

Ankimi

1. Për çdo vendim në zbatim të nenit 23, drejtuesit teknikë dhe drejtuesit ligjorë kanë të drejtën e ankimimit në KKR, brenda 10 ditëve nga data e publikimit të vendimit.
2. KKR pasi merr në shqyrtim ankesën e subjektit i paraqet ministrit propozimin përkatës. Ministri vendos brenda 60 ditëve.
 - a) Lënien në fuqi të vendimit të marrë.
 - b) Anulimin e vendimit të marrë.

Neni 25

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.